



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 korrik 2020
Nr. ref.:RK 1582/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. K107/20

Parashtrues

Arben Shala

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, Pml. nr. 284/2019, të 4 nëntorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Arben Shala, nga fshati Krajkovë, Komuna e Drenasit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga Ibrahim Dobruna, avokat nga Drenasi.

Vendimi i kontestuar

- Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 284/2019, të 4 nëntorit 2019, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 182/2019, të 23 majit 2019, si dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), Pkr. nr. 67/2018, të 8 marsit 2019.

Objekti i çështjes

- Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të gjykatave të rregullta me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 5. 3 dhe 4 (E drejta për liri dhe siguri) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
- Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata duhet të mbajë seancën dëgjimore publike *“për t’i qartësuar disa fakte dhe prova”*.
- Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon edhe vendosjen e masës së përkohshme me të cilën do të pezullohet ekzekutimi i Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Supreme të 4 nëntorit 2019.

Baza juridike

- Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], 39 [Kriteret e pranueshmërisë] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

- Më 15 janar 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
- Më 17 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
- Më 27 janar 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 10 korrik 2020, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se më 20 shkurt 2014, në ora 03:00, personi S.B. shkaktoi një aksident trafiku, në të cilin pasagjerja e tij pësoi lëndime trupore.
12. Në vendin në të cilin kishte ndodhur aksidenti, kanë ardhur, sipas detyrës zyrtare, parashtruesi i kërkesës dhe personi T.M., në cilësinë e zyrtarëve të Policisë së Kosovës për të kryer këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe për të përpiluar raportin zyrtar për rrethanat e aksidentit të trafikut.
13. Nga shkresat e lëndës rezulton se në të njëjtën ditë, personi S.B. paraqiti kallëzimin në Inspektoratin Policor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: IPK) kundër parashtruesit të kërkesës dhe personit T.M., siç theksoi në kallëzimin, *“për shkak se parashtruesi i kërkesës dhe personi T.M., e kanë marrë nga ai shumën e parave prej 100 euro, me qëllim që mos të hapin procedurën penale kundër tij”*.
14. Në bazë të këtij kallëzimi, IPK-ja e njoftoi Prokurorin e Shtetit dhe kërkoi që të nxirret një aktvendim me të cilin do të miratohen masat e fshehta të vëzhgimit, përgjimit dhe monitorimit të parashtruesit të kërkesës dhe personit T.M.
15. Më 20 shkurt 2014, Prokurori i Shtetit lëshoi Urdhëresën SEK. 19/-10/14, me të cilën urdhëroi masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, fotografimin e fshehtë ose vëzhgimin me video në vendet publike dhe monitorimin e fshehtë të bisedave në vendet publike për të dyshuarit.
16. Më 21 shkurt 2014 u mbajt takimi në restorantin X, në të cilin morën pjesë parashtruesi i kërkesës, personi T.M. dhe personi S.B. Me atë rast, IPK-ja, duke i përdorur masat e fshehta të miratuara, i mbledhi incizimet e bisedës, fotografitë, si dhe provat e tjera që ishin bazë e mjaftueshme për paraqitjen e kallëzimit penal nga IPK-ja.
17. Më 27 shkurt 2014, IPK paraqiti në Prokurorinë Themelore-Departamentin për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria), kallëzimin penal kundër parashtruesit të kërkesës dhe personit T.M., për shkak të dyshimit se në bashkëkryerje kishin kryer veprën penale *“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së”*.
18. Prokuroria, sipas kallëzimit penal të IPK-së, nxori Aktvendimin për zbatimin e hetimeve kundër parashtruesit të kërkesës dhe personit T.M. dhe i dërgoi një kërkesë gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në të cilën kërkoi caktimin e paraburgimit për parashtruesin e kërkesës dhe personin T.M.
19. Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Prishtinë nxori Aktvendimin me të cilin caktoi masën e paraburgimit për parashtruesin e

kërkesës dhe personin T.M. në kohëzgjatje prej një muaji, përkatësisht deri më 26 mars 2014.

20. Avokati i parashtruesit të kërkesës paraqiti ankesë ndaj Aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit.
21. Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Prishtinë e aprovoi ankesën e avokatit të parashtruesit të kërkesës dhe rrjedhimisht nxori Aktvendimin me të cilën e zëvendësoi masën e paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 26 shkurtit 2014 deri më 11 prill 2014.
22. Më 20 mars 2014, Prokuroria ngriti Aktakuzën PP. I. nr. 192/2014 në Gjykatën Themelore-Departamentin për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) kundër parashtruesit të kërkesës dhe personit T.M., për shkak të dyshimit të bazuar se kishin kryer veprën penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së*”.
23. Më 8 nëntor 2017, Gjykata Themelore mbajti seancën e shqyrtimit të hapur për publikun, ku morën pjesë parashtruesi i kërkesës si i pandehur me mbrojtësin e tij, si dhe prokurori. Me atë rast, prokurori i paraqiti provat nga aktakuza, ndërsa në të njëjtën kohë mbrojtësi i të pandehurit i paraqiti provat në mbrojtje të tij.
24. Më 14 nëntor 2017, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin PKR. nr. 147/14, me të cilin e gjykoi parashtruesin e kërkesës me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh në të cilin i llogaritet edhe koha e ka kaluar në arrestin shtëpiak.
25. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore theksoi se gjatë vërtetimit të veprës penale dhe caktimit të lartësisë së dënimit, ajo mori parasysh:

“Libri[n] – Raporti ditor i ndërrimit II – ndërrimi i natës, i Njësisë së Trafikut Rajonal në Prishtinë, i rasteve të aksidenteve në trafik i datës 19.02.2014, nga ora 23:00-07:00, sipas të cilit, gjatë kësaj periudhe kohore nuk është iniciuar asnjë aksident në komunikacionin rrugor;

Orari[n] ditor [të] punës i datës 20.02.2014, sipas së cilit tani të akuzuarit, natën kur ka ndodhur rasti kanë qenë në detyrë;

Raportin nga qendra klinike ku është transportuar personi i lënduar nga automjeti.

Transkriptin e dy CD të incizuara nga IPK gjatë hetimit të zhvilluar kundër parashtruesit të kërkesës, si dhe fotodokumentacionin.

Pra, nga dëshmitarët e dëgjuar, provat materiale të administruara dhe mbrojtjes së të akuzuarve, duke i analizuar secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve Arben Shala dhe T. M. ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të

veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, nga neni 422, par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK, prandaj të njëjtit gjykata i shpalli fajtorë, pasi më parë gjeti se janë penalisht të përgjegjshëm dhe iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.”

26. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, aplikimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të vendimit për sanksionimin penal dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga përgjegjësia penale apo që Aktgjykimi i goditur të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.
27. Më 15 shkurt 2018, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin PAKR. nr. 4/2018, me të cilin e aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR. nr. 147/2014, të 14 nëntorit 2017, e anuloi, dhe e ktheu çështjen lëndore në Gjykatën Themelore për rigjykim.
28. Gjykata e Apelit, në arsyetimin e Aktvendimit PAKR. nr. 4/2018, theksoi:

“Dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, gjykata nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare ndërsa ato që i ka dhënë nuk janë të mjaftueshme. Nuk ka dhënë arsye për secilën pikë të aktgjykimit, si dhe nuk është paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara apo të pavërtetuara, nuk ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse as arsyet për mosmiratimin e propozimit konkret të palëve dhe arsyet në të cilat është mbështetur me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje penale-juridike”.

29. Gjykata Themelore në rigjykim vazhdoi me seancat gjyqësore të cilat ishin të hapura për publikun. Gjykata Themelore i mbajti seancat gjyqësore më 30 korrik 2018, 12 shtator 2018 dhe 6 mars 2019.
30. Më 8 mars 2019, Gjykata Themelore në rigjykim nxori Aktgjykimin PKR. nr. 67/18, me të cilin e gjykoj parashtruesin e kërkesës me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajsh, në të cilin i llogaritet edhe periudha kohore e kaluar në arrest shtëpiak. Në arsyetimin e Aktgjykimit PKR. nr. 67/18, Gjykata Themelore theksoi se, *“...nga dëshmitarët e dëgjuar, provat materiale të administruara dhe mbrojtjes së të akuzuarit T. M., duke i analizuar secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve Arben Shala dhe T. M. ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, nga neni 422, par. 1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës - KPRK, prandaj të njëjtat gjykata i shpalli fajtorë, pasi më parë gjeti se janë penalisht të përgjegjshëm dhe iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit...”

31. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore PKR. nr. 67/18, ankesat e tyre i parashtruan Prokuroria dhe parashtruesi i kërkesës. Prokuroria, për shkak të vendimit për sanksionin penal, ndërsa parashtruesi i kërkesës për shkak të shkeljes së dispozitës së procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim.
32. Më 23 maj 2019, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PAKR. nr. 182/2019, me të cilin i refuzoi si të pabazuara ankesat e Prokurorisë dhe parashtruesit të kërkesës.
33. Në arsyetimin e Aktgjykimit PAKR. nr. 182/2019, Gjykata e Apelit, theksoi:

“Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së mbrojtësve të akuzuarve por edhe detyrës zyrtare konform nenit 394 par. 1 të KPRK-së, konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë, që kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka konstatuar se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsideron të vërtetuara, ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale. Aktgjykimi është hartuar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par. 7 të KPPK-së, është i qartë, konkret dhe i kuptueshëm, në arsyetim janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë vërtetuar drejt dhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë.

Prokuroria në ankesë nuk thekson rrethana konkrete rënduese të cilat kishin me ndikuar në ashpërsimin e dënimit, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë nuk thekson rrethana konkrete lehtësuese të cilat kishin me ndikuar në zbutjen e dënimit, përveç atyre që janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e të cilat rrethana në tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë, sepse sipas gjetjeve të kësaj gjykate, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është në proporcion me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale ashtu që kjo gjykatë konsideron se dënimi i shqiptuar është drejtë në proporcion me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, e sipas bindjes edhe të kësaj gjykate me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK“.

34. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 182/2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafët 1.8 dhe 1.12 të KPRK-së, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar, t'i ndryshojë aktgjykimet e kontestuara, në atë mënyrë që të lirojë të dënuarin nga akuza.
35. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me parashtruesin KMLP. II. nr. 200/2019, propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

36. Më 4 nëntor 2019, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pml. nr. 284/2019, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë.

37. Në arsyetimin e Aktgjykimit Pml. nr. 284/2019, Gjykata Supreme theksoi:

„Siç rezulton nga shkresat e çështjes, aktgjykimi i shkallës së parë i vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë, është i qartë dhe konkret, nuk ka kundërthënie qoftë me vetveten, me arsyetimin e tij apo me përmbajtjen e deklarimeve apo dokumenteve, përmban arsye të qarta të mjaftueshme mbi të gjitha faktet vendimtare. Në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë si të drejta dhe të ligjshme. Gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së kësaj çështje penale-juridike, e sidomos me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale.

Në pjesën e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit ku i referohet vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata Supreme e Kosovës, këto pretendime nuk i ka vlerësuar, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par. 2 KPRK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike“.

Pretendimet e parashtruesit

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet 22, 29, 31 dhe 53 të Kushtetutës, si dhe me nenet 5.3 dhe 5.4 të KEDNJ-së, si rezultat i mosrespektimit të procedurës hetimore dhe gjyqësore. *“Se gjatë mbajtjes së gjyqimit ai është trajtuar arbitrarisht si i akuzuar, dhe në këtë mënyrë është shkelur parimi i barazisë së armeve dhe parimi i kontradiktoritetit. Duke pasur parasysh se aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë të bazuara në shkelje, rezulton se edhe aktvendimi për caktimin e paraburgimit është në kundërshtim me ligjin dhe se ai është privuar arbitrarisht nga liria”.*

39. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se atij i është mohuar edhe e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një kohe të arsyeshme, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, nenin 6.1 të KEDNJ-së, si dhe me praktikën e GJEDNJ-së dhe në mbështetje të kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson disa raste: *Pretto kundër Italisë, Dimitrov dhe Hamanov kundër Bullgarisë.*

40. Parashtruesi i kërkesës shton se procedurat gjyqësore para gjykatës së shkallës së parë, gjykatës së shkallës së dytë dhe Gjykatës Supreme, në aspektin dhe kuptimin procedural dhe material, ishin të padrejta, *“pasi [që] parashtruesit të kërkesës i është cenuar e drejta e zhvillimit të procesit i cili do të mundësonte që në fund të merrej një vendim meritor në të mirë të tij. Parashtruesit i është mohuar e drejta e mbrojtjes gjyqësore, e paraqitjes, zhvillimit dhe shtjellimit*

të çështjes në mënyrë të rregullt procedurale dhe organike, në mënyrë që të merren parasysh pretendimet e tij, dhe në fund të merret një vendim meritor...”.

41. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat i kanë bazuar aktgjykimet e tyre në prova të papranueshme, të cilat janë edhe thelbësisht të pabesueshme, siç është përcaktuar me nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.29 të KPP-së, dhe si të tilla këto prova janë prova të papranueshme mbi të cilat nuk mund të bazohen vendimet.
42. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe se aktgjykimet e kontestuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, 1.8 dhe 1.12, si dhe nga neni 2 i KPP-së.
43. Më konkretisht, parashtruesi pretendon se shihet qartë që aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370, paragrafin 7 të KPP-së, dhe kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafët 1.8 dhe 1.12 të KPP-së. Shkeljet e lartcekura konsistojnë në faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara si dhe nuk ka arsyetuar aktgjykimin e saj.
44. Në mbështetje të pretendimit në lidhje me aktgjykimet e paarsyetuara, parashtruesi i kërkesës pretendon se, *“Gjykata Kushtetuese në aktgjykimet KI47/17 të dt. 28.12.2018, KI135/14 të 8 shkurtit 2016 si dhe në Aktgjykimin KI122/17, të dt. 30.04.2018, vërtetoi se mungesa e arsytimit në pretendimet kryesore të palëve përbënë shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës”.*
45. Parashtruesi më tej pretendon se gjykatat në procesin penal kundër tij kanë dështuar të sigurojnë një gjykim të drejtë, ato nuk i dëgjuan argumentet e tyre, por vetëm argumentet e prokurorit, se nga kjo konkludohet që ai është dënuar që më parë dhe se ato në këtë mënyrë e kanë shkelur edhe parimin *in dubio pro reo*.
46. Më tej, parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se Gjykata duhet të thërrasë seancën dëgjimore publike *“për t’i qartësuar disa fakte dhe prova, pasi që këtë nuk e kanë bërë gjykatat e rregullta”*. Në mbështetje të kësaj kërkesë, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“një seancë e tillë do të kishte rëndësi të posaçme meqenëse do t’u ofronte palëve mundësinë për të shpjeguar tutje çështjen në trajtim si dhe për t’u përgjigjur në pyetjet e mundshme që do të ndikonin në marrjen e një vendimi të drejtë”*.
47. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë masën e përkohshme me të cilën do të pezullohet ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të 4 nëntorit 2019.
48. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë që të nxjerrë një aktgjykim me të cilin do të konstatohet se gjykimi arbitrar i parashtruesit të kërkesës paraqet shkelje të të drejtave të tij individuale të garantuara me nenet 22, 29, 31 dhe 53

të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenet 5.3, 5.4 dhe 6 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht, të prishë aktgjykimet dhe të kthejë çështjen në rigjykim.

Dispozitat relevante gjyqësore në rastin konkret

Dispozitat Kushtetuese

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

*Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.
[...]*

“Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

*1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente.
[...]*”

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike..
[...]*

Nenet relevante të KEDNJ-së

“Neni 5 E drejta për liri dhe siguri

*1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:
[...]*

*c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
[...]*

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të

arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm. [...]"

Neni 6 E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]"

Dispozitat relevante ligjore

Ligji Nr. 03-L231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, nenet 17 dhe 19,

"Neni 17 Hetimet penale

Objekt i veprimtarisë hetimore të IPK-së është parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose jashtë saj, përfshirë edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv.

Neni 19 Mbledhja e të dhënave

Për përmbushjen e detyrës, hetuesit e IPK-së janë të autorizuar dhe janë përgjegjës të përdorin çfarëdo burimi të ligjshëm të informatave për të mbledhur, administruar dhe mbrojtur të dhënat që kanë të bëjnë me hetimin e veprave penale, të kryera nga punonjësit e Policisë, pavarësisht nga detyra e grada."

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, nenet 188 dhe 189,

"Neni 188 Procedura për urdhrin për paraburgim

1. Paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit pas seancës dëgjimore.

*Neni 189
Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij*

[...]

3. Secila palë mund të paraqesë ankesë brenda njëzet e katër (24) orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Nëse ankohet vetëm njëra palë, gjykata ia dërgon ankesën palës tjetër e cila argumentet e veta mund t'ia paraqesë gjykatës brenda njëzet e katër (24) orëve nga dorëzimi i ankesës. Për ankesë vendoset brenda dyzet e tetë (48) orëve nga paraqitja e saj.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

49. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të parapara më tej me Rregullore të punës.

50. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

51. Për më tepër, Gjykata i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

52. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 284/2019, të 4 nëntorit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë për të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kriteret nga neni 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

53. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

54. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte ngritur para saj disa pretendime si për shkeljen e të drejtave kushtetuese të garantuara me nenet 23, 31 dhe 53, ashtu edhe për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së.

55. Lidhur me këtë, Gjykata gjen se shumica e pretendimeve nga kërkesa e parashtruesit mund të grupohen në dy grupe të pretendimeve, të cilat janë **i**) pretendimet në lidhje me shkeljen e nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, dhe **ii**) pretendimet në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

56. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës, Gjykata, duke pasur parasysh vetë përmbajtjen dhe kuptimin e neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës, thekson se ajo, gjatë përcaktimit të bazueshmërisë së shkeljeve të pretenduara do të merr parasysh të gjitha mekanizmat dhe instrumentet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe rrjedhimisht do t'i zbatojë të gjitha garancitë e përgjithshme dhe specifike, parimet si dhe principet e parashikuara me nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës, të cilat janë të zbatueshme në rastin konkret.

57. Rrjedhimisht, në vazhdim të raportit, Gjykata do t'i analizojë veç e veç pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës të cilat ai i ka ndarë në dy grupe.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 paragrafët 3 dhe 4 të KEDNJ-së

58. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij i ndërton pretendimet për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së mbi shkeljet e garancive specifike të parashikuara në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 5 të KEDNJ-së.

59. Lidhur me këtë, Gjykata së pari rikujton se neni 29 i Kushtetutës në pjesën relevante thotë:

“Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] i Kushtetutës

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente [...].”

60. Gjithashtu, Gjykata rikujton se neni 5 i KEDNJ-së në pjesën relevante të paragrafëve 3 dhe 4 thotë:

“3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t’u paraqitur në procesin gjyqësor.

*4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.
[...].”*

61. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafët 3 dhe 4 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht gjen se parashtruesi në kërkesën e tij nuk shpjegon në mënyrë konkrete se si ka ndodhur shkelja e nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 paragrafit 3 dhe 4 të KEDNJ-së, por vetëm thekson se *“aktgjykimet e gjykatave të rregullta u morën me shkelje esenciale, prandaj mund të konkludohet se edhe masa e paraburgimit ishte në kundërshtim me ligjin”*.
62. Megjithatë, Gjykata, duke pasur parasysh kronologjinë e ngjarjeve, gjen se pretendimet për shkelje të nenit 5, paragrafit 3 dhe 4 të KEDNJ-së, mund të lidhen ekskluzivisht me periudhën kur parashtruesit të kërkesës përmes Aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake i është caktuar paraburgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh, i cili më vonë, me Aktvendimin e gjykatës së njëjtë është zëvendësuar me dënimin e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 30 ditësh. Nga kjo mund të konkludohet se parashtruesi i kërkesës konsideron se ai është privuar nga liria në mënyrë të paligjshme.
63. Duke pasur parasysh vetë rëndësinë e garancive të parashikuara me nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së, Gjykata konsideron si të nevojshme të analizojë pretendimet për të përcaktuar nëse parashtruesit të kërkesës i është shkelur neni 29 i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 3 dhe 4 të KEDNJ-së në kontekstin e privimit të paligjshëm dhe arbitrar nga liria në periudhën kur përmes Aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake i është caktuar arresti shtëpiak në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

64. Një qëndrim i tillë i Gjykatës është në përputhje edhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila në vendimet e saj theksoi se e drejta e lirisë dhe sigurisë personale renditet ndër të drejtat më të rëndësishme të njeriut, dhe se neni 5 i KEDNJ-së ofron mbrojtjen sipas së cilës askush nuk duhet të privohet nga liria në mënyrë arbitrare. Gjithashtu edhe përjashtimet nga ndalimi i privimit nga liria parashikohen me nenin 5 të KEDNJ-së. Në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, kjo është një procedurë shteruese e cila duhet të interpretohet në kuptim të ngushtë (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 18 janarit 1978, Seria A25). Vetëm një qasje e tillë është në përputhje me nenin 5 të KEDNJ-së, përkatësisht për të siguruar se askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga liria (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Quinn kundër Francës*, të 22 marsit 1995, Seria A-311, dhe *Winterwerp kundër Holandës*, Aktgjykim i 24 tetorit 1979, Seria A-33).
65. Më tej, Gjykata rikujton se GJEDNJ në praktikën e saj ka marrë qëndrimin se ekzistenca e një „*dyshimi të arsyeshëm*“ mbi të cilin bazohet privimi nga liria përbën një pjesë thelbësore të garancive kundër privimit arbitrar nga liria dhe paraqet *conditio sine qua non*, përkatësisht „*kushtin pa të cilin nuk mund*“ të caktohet apo vazhdohet paraburgimi. Ekzistenca e „*dysimit të arsyeshëm*“ presupozon ekzistencën e fakteve apo informatave mbi bazën e të cilave, siç ka treguar GJEDNJ, një vëzhgues objektiv do të konkludojë se personi në fjalë mund ta ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Ajo çka mund të paraqitet si „*e arsyeshme*“, do të varet nga tërësia e rrethanave të rastit. Madje edhe në rastet kur nga policia dhe organet e tjera të ndjekjes kërkohet të veprojnë me urgjencë për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë publike, autoriteti publik duhet të ofrojë të paktën disa fakte apo informata nga të cilat do të shihej se ka ekzistuar një dyshim i arsyeshëm se personi i privuar nga liria kishte kryer veprën penale e cila i vihet në barrë (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 30 gushtit 1990, Seria A numër 182, paragrafët 32-34) dhe *Stepuleac kundër Moldavisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 6 nëntorit 2007, kërkesa numër 8207/06, paragrafi 68).
66. Gjykata gjithashtu tregon se në momentin e caktimit të paraburgimit nuk është e domosdoshme të vërtetohet me siguri se vepra penale për të cilën personit i caktohet paraburgimi është kryer me të vërtetë, dhe në fund, Gjykata shton se në pajtim me nenin 5 të KEDNJ-së, caktimi i paraburgimit duhet të jetë në përputhje me ligjin e brendshëm.
67. Sa i përket garancive specifike të parashikuara me paragrafin 3, të nenit 5 të KEDNJ-së, Gjykata tregon se dispozitat e nenit 5, paragrafit 3 të KEDNJ-së kërkojnë që personi të jetë i privuar nga liria në pajtim me nenin 5, paragrafin 1.c., përkatësisht që privimi të jetë „i ligjshëm“ në kuptimin e këtij neni dhe të përfshijë në mënyrë të barabartë edhe mbrojtjen procedurale dhe materiale të personave të tillë. GJEDNJ konkludoi se respektimi i nenit 5, paragrafit 3 të KEDNJ-së kërkon që autoriteti gjyqësor të rishikojë të gjitha çështjet në lidhje me paraburgimin dhe të nxjerrë vendimin për paraburgimin duke iu referuar kritereve objektive të parashikuara me ligj. Kështu, ekzistenca e *dysimit të arsyeshëm* se personi i cili është privuar nga liria e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë është *conditio sine qua non* për caktimin apo vazhdimin e

paraburgimit (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Trzaska kundër Polonisë*, kërkesa nr. 25792/94, të 11 korrikut 2000).

68. Duke i sjellë në lidhje parimet e përmendura me rastin konkret, Gjykata vëren se gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore, në çështjen penale kundër të pandehurit (parashtruesit të kërkesës), për shkak të dyshimeve për keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, nxori Aktvendimin për caktimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës në kohëzgjatje prej 30 ditësh.
69. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari vëren se vendimit të tillë i kanë paraprirë veprimet procedurale të cilat janë ndërmarrë nga organet shtetërore me qëllim të vërtetimit të ekzistencës së veprës penale, përkatësisht të „*dysimit të arsyeshëm*” se parashtruesi i kërkesës me të vërtetë ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.
70. Më konkretisht, IPK-ja, si rezultat i kallëzimit të të dëmtuarit se parashtruesi i kërkesës kishte kryer veprën penale, e në bazë të miratimit SEK.19/-10/14 të Prokurorit të Shtetit, ndërmori masa të fshehta teknike, hetimore dhe vëzhguese, fotografimin e fshehtë apo vëzhgimin me video në vendet publike dhe monitorimin e fshehtë të bisedave në vendet publike për të dyshuarit.
71. Gjykata vëren se nenet 17 dhe 19 të Ligjit nr. 03-L/231 për Inspektoratin Policor të Kosovës e rregullojnë pikërisht edhe çështjen e kompetencave të IPK-së për zhvillimin e hetimeve penale dhe për mbledhjen e të dhënave. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se nenet 17 dhe 19 të këtij Ligji, përcaktojnë:

“Neni 17 Hetimet penale

17. Objekt i veprimtarisë hetimore të IPK-së është parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose jashtë saj, përfshirë edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv.

Neni 19 Mbledhja e të dhënave

19. Për përmbushjen e detyrës, hetuesit e IPK-së janë të autorizuar dhe janë përgjegjës të përdorin çfarëdo burimi të ligjshëm të informatave për të mbledhur, administruar dhe mbrojtur të dhënat që kanë të bëjnë me hetimin e veprave penale, të kryera nga punonjësit e Policisë, pavarësisht nga detyra e grada.”

72. Gjykata më tej vëren se në atë rast, IPK-ja mblodhi fakte dhe prova që tregonin se ekzistojnë indikacione të mjaftueshme se parashtruesi i kërkesës kishte kryer veprën penale për të cilën personi S.B. e kishte kallëzuar në IPK.
73. Ky veprim procedural i zbatuar nga IPK-ja ka ndikuar në rrjedhën e mëtejme të procedurës kundër parashtruesit të kërkesës. Më konkretisht, IPK-ja, si rezultat i provave të mbledhura, paraqiti kallëzimin penal pranë prokurorit,

duke e vendosur parashtruesin e kërkesës në pozitën e “*të dyshuarit, e jo të pandehurit*”.

74. Prokuroria, duke pasur parasysh kallëzimin penal të IPK-së, materialin provues të mbledhur i cili është siguruar gjatë masave të fshehta teknike, hetimore dhe vëzhguese, nxori vendimin për zbatimin e hetimeve dhe kërkoi nga gjyqtari i procedurës paraprake të caktojë masën e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës.
75. Sa i përket pjesës së deritanishme të procedurës, Gjykata nuk e gjen ndonjë të metë në hapat procedural të ndërmarrë nga autoritetet kompetente me qëllim të vërtetimit të “*dyshimit të arsyeshëm*”, i cili, në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, duhet të ekzistojë si parakusht themelor për rrjedhën e mëtejshme të procedurës para autoriteteve kompetente që do të vendosin për bazueshmërinë e kërkesës për caktimin e paraburgimit ndaj personit të dyshuar.
76. Gjykata më tej gjen se gjyqtari i procedurës paraprake, vetëm pas përmbushjes së të gjitha kushteve, përkatësisht vetëm pas ofrimit të fakteve dhe informatave të nevojshme nga autoritetet kompetente shtetërore, IPK-ja dhe Prokuroria, nga të cilat është parë se ekziston *dyshimi i arsyeshëm*, e për qëllime të interesit publik, nxori vendimin për caktimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës në kohëzgjatje prej 30 ditësh.
77. Gjykata vëren se çështja e caktimit të paraburgimit rregullohet me nenin 188 të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i cili thotë:

“Neni 188 Procedura për urdhrin për paraburgim

1. Paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit pas seancës dëgjimore.”
78. Rrjedhimisht, imponohet përfundimi se autoritetet kompetente i kanë ofruar gjyqtarit kompetent arsye të mjaftueshme dhe konkrete si dhe arsyetime në lidhje me parashtruesin e kërkesës në mbështetje të përfundimit për ekzistencën e “*dyshimit të arsyeshëm*” dhe arsyeve specifike për caktimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës.
79. Në mbështetje të kësaj, Gjykata gjen se vetë procedura e caktimit të paraburgimit prej 30 ditësh ndaj parashtruesit të kërkesës nga gjyqtari i procedurës paraprake nuk ka paragykuar në asnjë mënyrë rezultatin e procedurës së tij penale të zhvilluar nga gjykatat e rregullta, përkatësisht nuk ka ndikuar drejtpërdrejtë në përcaktimin e rezultatit të procedurës gjyqësore lidhur me fajësinë e tij, e që mund të shihet edhe në bazë të kronologjisë së mëtutjeshme të ngjarjeve që pasuan.
80. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkeljen e paragrafit 4, të nenit 5 të KEDNJ-së. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se neni 5, paragrafi 4 i KEDNJ-së i garanton „*çdo personi, të cilit i është hequr liria me arrestim ose*

me burgim“ të iniciojë procedurën e vlerësimit të ligjshmërisë së paraburgimit dhe të lirohet në qoftë se paraburgimi ka qenë i paligjshëm.

81. Duke u kthyer në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, duke e shfrytëzuar mundësinë ligjore të paraparë në nenin 189, paragrafin 3 të Kodit të Procedurës Penale, ka paraqitur ankesën ndaj aktvendimit të shkallës së parë të gjyqtarit të procedurës paraprake për caktimin e paraburgimit, duke krijuar kështu mundësinë që gjykata e rregullt të rishqyrtojë dhe të vlerësojë ligjshmërinë e vendimit të saj.
82. Përveç kësaj, Gjykata rikujton se sipas praktikës së GJEDNJ-së, garancitë e nenit 5, paragrafit 4 të KEDNJ-së mund të humbin thelbin e tyre në qoftë se gjykata, duke u mbështetur në ligjin dhe praktikën vendore, i neglizhon apo i trajton si të parëndësishme faktet ankimore dhe kështu mund të vihet në dyshim ekzistenca e kushteve të cilat në pajtim me KEDNJ janë të ligjshme në aspektin e privimit të lirisë (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Nikolova kundër Bullgarisë* [DHM], nr. 31195/96, paragrafi 61, GJEDNJ 1999-II).
83. Megjithatë, në rastin konkret, Gjykata gjen se pikërisht ky veprim procedural i parashtrimit të ankesës në gjykatën kompetente nga avokati i parashtruesit të kërkesës rezultoi edhe me aktvendimin e dytë të gjyqtarit të procedurës paraprake, i cili e zëvendësoi masën e paraburgimit me masën më të lehtë të arrestit shtëpiak, dhe nga kjo mund të konkludohet padyshim se gjykata nuk i ka injoruar apo neglizhuar faktet të cilat avokati i parashtruesit të kërkesës i ka cekur në ankesën për rishikimin e aktvendimit për caktimin e paraburgimit.
84. Në bazë të gjetjeve të saj të cilat i ka arritur duke e shqyrtuar në tërësi procedurën e përfunduar me aktvendimin e shkallës së dytë për caktimin e arrestit shtëpiak ndaj parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton se autoritetet kompetente nuk i kanë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 5, paragrafët 3 dhe 4 të KEDNJ-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

85. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se parashtruesi në mbështetje të këtyre pohimeve paraqiti një numër të madh të pretendimeve të cilat i ndërlidh me *a*) përdorimin e provave të cilat janë mbledhur në mënyrë të paligjshme dhe zbatimin e gabuar të ligjit, *b*) shkeljen e parimit *in dubio pro reo*, *c*) kohëzgjatjen e procedurës dhe *d*) vendimet e paarsyetuara gjyqësore. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të këtyre pretendimeve iu referua praktikës së Gjykatës Kushtetuese, si dhe praktikës së GJEDNJ-së.
86. Gjykata, duke pasur parasysh faktin se ajo tashmë e kishte analizuar një pjesë të procedurës në lidhje me shkeljen e nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së, të cilën parashtruesi e ndërlidhi me rrjedhën e procedurës së caktimit të paraburgimit dhe kishte konstatuar se nuk ka pasur shkelje, thekson se ajo, gjatë analizës së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për

shkeljet e mundshme të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, do të kufizohet vetëm në procedurën gjyqësore e cila është zhvilluar para gjykatave të rregullta në të cilën është bërë vërtetimi i përgjegjesisë penale të parashtruesit të kërkesës.

a) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për përdorimin e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme si dhe për zbatimin e gabuar të ligjit

87. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pohimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së pretendon se gjykatat i morën aktgjykimet bazuar në provat e mbledhura gjatë masave të fshehta të vëzhgimit, dhe se ato, si të tilla, janë të pabesueshme dhe të paligjshme në pajtim me nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.29 të KPP-së, dhe se nga kjo mund të konkludohet se gjykatat e zbatuan ligjin në mënyrë të gabuar.
88. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, e cila nënvizoi se *“pika që duhet të shqyrtohet është ajo nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj”* (shih rastet e GJEDNJ-së *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 35394/97, Aktgjykim i 12 majit 2000, paragrafi 34; *P.G. dhe J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 44787/98, Aktgjykim i 25 shtatorit 2001, paragrafi 76; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 48539/99, Aktgjykim i 5 nëntorit 2002, paragrafi 42).
89. Megjithatë, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me mbledhjen e paligjshme të provave, *“dhe [se] rrjedhimisht ato, si të tilla, janë të pabesueshme, sipas nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.29 të KPP-së”*, Gjykata rikujton se neni 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.29 i KPP-së, parashikon se:
- “1.29. Thelbësisht të pambështetshme – prova apo informata është thelbësisht e pambështetshme nëse origjina e provës apo informatës është e panjohur, bazohet në thashetheme apo në dukje të parë apo informata është e pamundshme ose e pabesueshme”.*
90. Duke u kthyer në pretendimin konkret të parashtruesit të kërkesës, më saktësisht në origjinën e provave të përdorura nga gjykatat me rastin e vërtetimit të fajësisë së tij, Gjykata gjen se origjina e provave të kontestuara nga parashtruesi nuk është e panjohur, përkatësisht se ato, si të tilla, janë mbledhur nga IPK-ja gjatë masave të fshehta të vëzhgimit, dhe për më tepër, IPK-ja i ka ndërmarrë këto veprime vetëm pas urdhërësës SEK.19/-10/14 të Prokurorit të Shtetit të 20 shkurtit 2014, me të cilën urdhërohet *“zbatimi i masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, fotografimi i fshehtë ose vëzhgimi me video në vendet publike dhe monitorimi i fshehtë i bisedave në vendet publike për të dyshuarit”*.
91. Nga kjo edhe mund të konkludohet se ato si të tilla nuk janë të paligjshme për arsye se Gjykata tashmë ka konstatuar se ato janë mbledhur nga IPK-ja në mënyrën e rregulluar me vetë ligjin, më saktësisht me nenin 19 të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin e Policisë së Kosovës, dhe se çështja e ligjshmërisë

së tyre ka kaluar dy herë verifikimin përmes kontrollit gjyqësor të gjykatave të rregullta gjatë procedurës së vërtetimit të përgjegjësive penale të parashtruesit të kërkesës.

92. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës të cilat kanë të bëjnë ekskluzivisht me mënyrën në të cilën gjykatat e rregullta kishin vërtetuar gjendjen faktike dhe zbatuar të drejtën materiale, Gjykata rikujton se ajo në vazhdimësi ka theksuar se këto pretendime bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata (shih, lidhur me këtë, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35, KI154/17 dhe 05/18, parashtruesit e kërkesës *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, KI192/18, parashtruesi i kërkesës *Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji, KEDS Sh.A.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 gushtit 2019, paragrafi 49).
93. Gjykata, gjithashtu, përmes praktikës së saj gjyqësore vazhdimisht ka theksuar se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit apo të faktit, që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih, ndër të tjera, edhe rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011, KI154/17 dhe 05/18, parashtruesit e kërkesës *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 61, KI192/18, parashtruesi i kërkesës *Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji, KEDS Sh.A.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 gushtit 2019, paragrafi 50).
94. Rrjedhimisht, Gjykata hedh poshtë si të pabazuara të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit dhe mënyrën në të cilën janë mbledhur provat gjatë hetimeve, e të cilat ai i kishte ndërlidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

b) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e parimit in dubio pro reo

95. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se nuk është respektuar parimi i prezumimit të pafajësisë, as parimi *in dubio pro reo*, Gjykata thekson se, sipas praktikës së GJEDNJ-së, prezumimi i pafajësisë nënkupton se i akuzuari nuk është i detyruar të mbrohet, edhe pse ai e ka të drejtën e mbrojtjes, përkatësisht nuk është i detyruar të dëshmojë pafajësinë e tij, ndërsa barra e provës i takon prokurorit. Në pajtim me këtë, gjykata duhet të nxjerrë aktgjykimin lirues jo vetëm atëherë kur është e bindur në pafajësinë e të akuzuarit, por edhe atëherë kur nuk është e bindur as në fajësinë e tij, as në

pafajësinë e tij. Domethënë, kur ka dyshime, gjykata duhet të zbatojë parimin *in dubio pro reo*, i cili është një element thelbësor i së drejtës për gjykim të drejtë nga neni 6 i KEDNJ-së (shih, aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, të 6 dhjetorit 1988, Seria A, numër 146, paragrafi 77).

96. Në këtë kuptim, gjykatat janë të obliguara të çmojnë çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku dhe në bazë të çmuarjes së tillë me ndërgjegje të nxjerrin konkludimin nëse një fakt është provuar apo jo. Nëse pas përfundimit të procedurës penale ngelet dyshimi në raport me përgjegjësinë penale të të akuzuarit, gjykata duhet të nxjerrë aktgjykimin lirues.
97. Duke marrë parasysh arsyetimin e mëparshëm në këtë vendim, si dhe duke pasur parasysh faktin se çështja e përgjegjësisë penale të parashtruesit ishte objekt i verifikimit të posaçëm, si nga ana e Gjykatës Themelore ashtu edhe nga ana e Gjykatës së Apelit në dy procedura, pas vlerësimit të ndërgjegjshëm të provave, veç e veç dhe në lidhje me provat e tjera, imponohet konkludimi se ato nuk kishin as edhe dyshimin më të vogël për ekzistimin, gjegjësisht, mosekzistimin e ndonjërit prej fakteve vendimtare që përbëjnë elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar parashtruesi i kërkesës, dhe me vetë këtë as dyshimin për ekzistimin e përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, Gjykata vëren se ato kanë dhënë arsye të detajuara, të bindshme dhe logjike për përfundimet e tyre, të cilat nuk tregojnë për ndonjë arbitraritet në vendimmarrjen e tyre.
98. Në lidhje me këtë, Gjykata gjen se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se aktgjykimet e kontestuara nuk e përmbushin parimin *in dubio pro reo* si një element të së drejtës për gjykim të drejtë të mbrojtur me nenin 6 paragrafi 2 të KEDNJ-së, janë gjithashtu qartazi (*prima facie*) të pabazuara.

e) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore

99. Sa i përket pretendimit lidhur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, Gjykata thekson se sipas praktikës konsistente të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës Kushtetuese, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit të veçantë, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese, dhe në veçanti për ndërlíkueshmërinë e rastit, sjelljen e palëve në procedurë, sjelljen e gjykatës kompetente dhe autoriteteve të tjera publike, si dhe rëndësinë të cilën çështja konkrete juridike ka për parashtruesin e kërkesës (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Mikulić kundër Kroacisë*, kërkesa numër 53176/99, të 7 shkurtit 2002, Raporti numër 2002-I, paragrafi 38; si dhe rastin e Gjykatës: KI23/16, parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 marsit 2017).
100. Përkitazi me pjesën e kërkesës e cila ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës para gjykatave të rregullta, parashtruesi konsideron se ai nuk ka pasur një gjykim të drejtë për arsye se procedura penale zgjati më tepër se katër vite, sjellja e tij ishte shembullore dhe se vonesa dhe gjatësia kanë ndodhur ekskluzivisht për shkak të sjelljes së autoriteteve publike. Në mbështetje të

kësaj, parashtruesi theksoi edhe praktikën e GJEDNJ-së në rastin *Preto kundër Italisë*.

101. Me rastin e shqyrtimit të këtyre pretendimeve, Gjykata analizoi procedurën në lëndën penale e cila është zhvilluar kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale *“keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së”*. Në këtë drejtim, Gjykata mund të konstatojë se procedura për të cilën parashtruesi në kërkesë pretendoi se zgjati më tepër se 4 vite, në të vërtetë është procedura në të cilën është vërtetuar përgjegjësia penale e parashtruesit e cila ka zgjatur diç më pak se 6 vite.
102. Megjithatë, Gjykata me këtë rast gjithashtu vërejtë se ekziston një specifikë e caktuar e cila ndikoi në vetë gjatësinë e kësaj procedure. Më konkretisht, Gjykata konkludoi se ekzistojnë dy procedura gjyqësore lidhur me vërtetimin e përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës.
103. Konkretisht, procedura e parë para Gjykatës Themelore zgjati prej 20 marsit 2014, kur prokurori ngriti aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës dhe kjo pjesë e procedurës gjyqësore përfundoi më 15 shkurt 2018, atëherë kur Gjykata e Apelit i aprovoi pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke e kthyer çështjen në rigjykim. Lidhur me këtë, Gjykata gjen se procedura e parë përfundoi për diç më pak se 4 vite dhe se në të njëjtën gjykatat nxorën dy aktgjykime gjyqësore.
104. Sa i përket kësaj procedure të parë gjyqësore, nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore ndërmori veprime të ndryshme procedurale me qëllim të dëgjimit të dëshmitarëve, ku gjithashtu mbajti edhe dy shqyrtime gjyqësore, më 8 dhe 14 nëntor 2017, në të cilat prokuroria dhe mbrojtja e parashtruesit paraqitën provat e tyre. Gjithashtu, nga procedura para Gjykatës së Apelit, mund të konkludohet se përkundër faktit se parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur shumë pretendime ankimore që Gjykata e Apelit do të duhej t'i analizonte, ajo kishte arritur që brenda periudhës prej 3 muajsh, përkatësisht më 15 shkurt 2018, të nxjerrë Aktvendimin me të cilin e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe e ktheu çështjen në Gjykatën Themelore për rigjykim.
105. Lidhur me procedurën e përsëritur gjyqësore, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në procedurën e përsëritur ka qenë shumë efikase, gjë që tregon edhe numri i shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura, ku numri i tyre ishte gjithsej 4 (më dt. 30.07.2018, 12.09.2018, 06.03.2019 dhe 08.3.2019), ku Gjykata Themelore është dashur që përsëri t'i analizojë dhe eliminojë të gjitha vërejtjet dhe të metat e cekura nga Gjykata e Apelit në dispozitivin e Aktgjykimin të 15 shkurtit 2018 dhe, përkundër këtij fakti, ajo nxori Aktgjykimin për diç më pak se një vit.
106. Më tej, procedura para Gjykatës së Apelit në rigjykim zgjati diç më shumë se 2 muaj, përkatësisht deri më 23 maj 2019, kur ajo nxori Aktgjykimin sipas ankesës së parashtruesit. Ndërsa procedura para Gjykatës Supreme zgjati diç më shumë se 4 muaj, përkatësisht deri më 4 nëntor 2019, kur ajo nxori Aktgjykimin e formës së prerë lidhur me përgjegjësinë penale të parashtruesit të kërkesës.

107. Bazuar në të gjitha sa më sipër, Gjykata nuk gjen se kohëzgjatja e procedurës gjyqësore në rastin konkret i tejkalon kufijtë e «arsyeshmërisë» në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafit 1 të KEDNJ-së.

d) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për vendimet e paarsyetuara gjyqësore

108. Gjykata vëren se parashtruesi pretendimet e tij për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me vendimet e paarsyetuara gjyqësore i ndërton mbi pohimet “*se shkeljet e pretenduara janë krijuar në atë mënyrë që gjykatat e rregullta nuk i kanë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë faktet të cilat i konsiderojnë të vërtetuara dhe për të cilat arsye ai konsiderohet fajtor*”, dhe në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës thekson edhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese në rastet KI47/17, të dt. 28.12.2018, dhe KI135/14, të 8 shkurtit 2016, si dhe Aktgjykimin KI122/17, të 30.04.2018, në të cilat Gjykata konstatoi “*se mungesa e arsyetimit në pretendimet kryesore të palëve përbënë shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës*”.
109. Sa i përket pretendimeve lidhur me vendimet e paarsyetuara gjyqësore, Gjykata Kushtetuese thekson se sipas praktikës së vendosur të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës Kushtetuese, neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së i obligon gjykatat, ndër të tjera, të arsyetojnë aktgjykimet e tyre. Ky obligim, megjithatë, nuk mund të kuptohet si detyrim që në aktgjykim të paraqiten të gjitha detajet dhe të jepen përgjigje në të gjitha pyetjet dhe argumentet e paraqitura. Masa në të cilën ekziston ky obligim varet nga natyra e vendimit (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, të 9 dhjetorit 1994, Seria A, numër 303-A, paragrafi 29). GJEDNJ dhe Gjykata Kushtetuese në vendimet e shumta treguan se gjykatat vendore kanë një vlerësim të caktuar diskrecional në lidhje me atë se cilat argumente dhe prova do t’i pranojnë në rastin e caktuar, por njëkohësisht kanë edhe obligimin ta arsyetojnë vendimin e tyre, duke ofruar arsye të qarta dhe të kuptueshme mbi të cilat e kanë bazuar atë vendim (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Suominen kundër Finlandës*, të 1 korrikut 2003).
110. Gjykata konsideron se në rastin konkret analiza gjithëpërfshirëse e provave të administruara nuk mungon, por Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj e përshkoi në tërësi procesin e vlerësimit të provave veç e veç, ndërlidhjen e tyre dhe nxjerrjen e përfundimit se parashtruesi kishte kryer veprën penale dhe është penalisht i përgjegjshëm për kryerjen e së njëjtës. Konkretisht, Gjykata vëren se Gjykata Themelore zbatoi një procedurë shumë të gjerë provuese edhe në procedurën e përsëritur, se në këtë kuptim i dëgjoi përsëri dëshmitarët, e zbatoi ekspertizën e provave të mbledhura gjatë masave të fshehta të vëzhgimit nga IPK-ja, si dhe shqyrtoi dokumentacion voluminoz i cili gjendet në shkresat e lëndës.
111. Në bazë të procedurës provuese të zbatuar në këtë mënyrë, gjykatat e rregullta konstatuan se parashtruesi i kërkesës, në mënyrën dhe në kohën e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimeve, kishte kryer veprën penale “*keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së*” dhe se për të gjitha konkluzionet e tyre, ato

ofruan arsytetime të hollësishme dhe të qarta të cilat në asnjë pjesë nuk duken si arbitrare apo të papranueshme vetvetiu, as nuk i sjellin në dyshim konkluzionet për kryerjen e veprës penale nga parashtruesi i kërkesës, për të cilën ai është gjykuar me dënim të formës së prerë.

112. Gjykata gjithashtu thekson se ajo vuri re që parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se Gjykata Kushtetuese në një numër të caktuar të aktgjykimeve të saj kishte konstatuar shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi që gjykatat nuk i arsytuan vendimet e tyre në pajtim me parimet e së drejtës për vendim të arsytuar gjyqësor.
113. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se është fakt i padiskutueshëm që Gjykata në një numër të vendimeve të saj gjeti shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, të cilat i ndërlidhi me vendimet e paarsyetuara gjyqësore, por gjithashtu, Gjykata dëshiron të theksojë se secili rast para Gjykatës Kushtetuese i ka veçantitë dhe specifikat e veta, të cilat mund të paraqesin arsye të mjaftueshme që Gjykata të konstatojë një shkelje të caktuar. Megjithatë, çdo thirrje në aktgjykimet e tilla dhe krahasimi i rastit të vet me rastet e tilla, nuk paraqet arsye dhe bazë të mjaftueshme që Gjykata edhe në rastin konkret, të konstatojë shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
114. Bazuar në të gjitha sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se vendimet e paarsyetuara gjyqësore kanë rezultuar me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, janë të pabazuara.
115. Rrjedhimisht, Gjykata, bazuar në të gjitha sa më sipër, konsideron se gjykatat e rregullta kanë respektuar detyrën e tyre sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, lidhur me garancitë procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, prandaj pretendimet e parashtruesit të kërkesës se me vendimet e kontestuara është shkelur e drejta për gjykim të drejtë janë të pabazuara në këtë segment.

Përfundim

116. Gjykata gjen se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se veprimi procedural i caktimit të arrestit shtëpiak dhe procedura gjyqësore në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë penale, ishin të padrejta apo arbitrare, në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar ndonjë garanci procedurale që do të rezultonte me shkelje të së drejtës së garantuar me nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së, si dhe me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
117. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës që të mbështet pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqet dëshminë *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, të 5 dhjetorit 2013).

118. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

119. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme me të cilën do të pezullohet ekzekutimi i Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Supreme të 4 nëntorit 2019.
120. Megjithatë, Gjykata sapo ka konkluduar se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme në baza kushtetuese.
121. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi që kërkesa është deklaruar e papranueshme.

Kërkesa për seancë dëgjimore publike

122. Gjykata, përveç pretendimeve të tjera në kërkesë, vuri re se parashtruesi kërkon edhe mbajtjen e seancës publike, duke pretenduar se Gjykata Kushtetuese duhet të thërrasë seancën dëgjimore publike *“për t’i qartësuar disa fakte dhe prova, pasi që këtë nuk e kanë bërë gjykatat e rregullta”*. Në mbështetje të kësaj kërkesë, parashtruesi pretendon se *“një seancë e tillë do të kishte rëndësi të posaçme meqenëse do t’u ofronte palëve mundësinë për të shpjeguar tutje çështjen në trajtim si dhe për t’u përgjigjur në pyetjet e mundshme që do të ndikonin në marrjen e një vendimi të drejtë”*.
123. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.*
- 2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.”*
124. Gjykata vëren se nuk ekzistojnë arsyet në të cilat është thirrur parashtruesi i kërkesës në mbështetje të kësaj kërkesë.
125. Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur për këtë rast sipas formulimit të nenit 20 paragrafi 2 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI34/17, parashtruese e kërkesës *Valdete Daka*, Aktgjykim i 12 qershorit 2017, paragrafët 108-110).
126. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit për mbajtje të seancës dëgjimore verbale refuzohet si e pabazuar.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27.1 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 57 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 qershor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. TË REFUZOJË kërkesën për mbajtje të seancës publike;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- V. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi